

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

As fjalori i rrugës dhe as gjuha banale nuk e shpëtojnë dot hajdutin e Surrelit. Erdhi sot si një kufomë politike, me një çehre herë i nxirë, herë i zverdhur, por nuk tha asnjë fjalë për korrupsionin ndërkombëtar. Kot e ke, Edvin, nuk i shpëton dot hetimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndaj merre me qetësi, sepse ke rrugë të gjatë! Të dashur qytetarë, përveç mocionit me debat, interpelancës apo pyetjeve, ne kemi kërkuar edhe ngritjen e komisionit hetimor për çështjen “Rama-McGonigal”. Kemi firmosur 44 deputetë të Partisë Demokratike dhe Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar qartë se, kur 35 deputetë kërkojnë ngritjen e një komisioni hetimor, është detyrim kushtetues që komisioni të ngrihet menjëherë. Por Edi Rama shprehet se nuk kemi asnjë shans për ta ngritur komisionin hetimor, sepse kështu na paska urdhëruar ai. Po ju, kolegë të mazhorancës, deri kur do të bëheni mburojë e tij, deri kur me forcën e kartonëve do të rrëzoni të gjitha kërkesat tona, sepse kështu ka sugjeruar ai? E, pra, ky nuk mund të quhet parlament për sa kohë që cenohet dhe dhunohet fjala e lirë, shkelet e dhunohet Kushtetuta e vendit dhe Rregullorja e Kuvendit! Ky parlament tashmë është shndërruar në noter të aferave korruptive të Ramës dhe po të kishim një shtet ligjor, një shtet të së drejtës, Edi Rama sot duhej të ishte në burg. Ky është një moment i pashembullt i akteve antishqiptare, antikombëtare, antidemokratike dhe antiamerikane të Edi Ramës. Shqipëria sot ndodhet në qendër të një cikloni të fuqishëm medietik botëror, në qendër të një rasti që tejkalon çdo lloj imagjinate. Takimet e fshehta të Çarls McGonigal-it me Edi Ramën, angazhimi i tij me pagesë për të sharruar shtyllën kryesore të rendit demokratik, që është pluralizmi politik, për të shkatërruar opozitën për hir të pushtetit të Edi Ramës, është një krim i përmasave makabre. Sot është koha të flasë opozita, të flasë deri në largimin e këtij turpi të njeriut që nuk ka asnjë parim, asnjë normë, as moral, nder e dinjitet, që nuk njeh asnjë kufi në poshtërsitë e tij, për të qëndruar vetë në pushtet, pavarësisht se çfarë i shkakton demokracisë apo vendit të tij.

Të dashur qytetarë, ky individ nuk mund të qëndrojë më asnjë ditë të vetme në atë karrige, të blerë më 21 prill 2021. Është hajduti i tri koncesioneve korruptive në shëndetësi, me vlerë 350 milionë euro, është hajduti i tre inceneratorëve fantazmë me vlerë 430 milionë euro; është hajduti i 22 milionë eurove apo i 137 udhëtimeve me charter; është abuzuesi i 8,2 miliardë eurove në fondet publike; është nxitësi i shpopullimit të 1 milion shqiptarëve; është ky individ që e shndërroi Shqipërinë në Kolumbinë e dytë, si rruga kryesore e kokainës, heroinës dhe kanabisit; është arkitekti i sistemit të patronazhistëve dhe aktivistëve. Është ky individ që i vuri njollën e zezë të turpit Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Shkurt e shqip, është një kufomë politike dhe asgjë më shumë! Të dashur qytetarë të Lezhës dhe të mbarë Shqipërisë, secili prej jush përballet me varfërinë, me papunësinë dhe me pamundësinë ekonomike, pikërisht për shkak të këtij korrupsioni galopant. Kjo qeveri dhe ky individ, i ashtuquajtur Kryeministër, nuk ju ka pasur ndonjëherë prioritet, as kur përmbytëni, as kur bie tërmeti apo Covid-i. Në mënyrë të përsëritur, Lezha çdo vit përballet me përmbytje. Madje, e quani “situatë normale” kur Lezha shndërrohet në Venecia, dhe normaliteti për ju është çështje e ditës. Uji vërshoi

në katet e para të shtëpive, të pallateve dhe në të gjitha dyqanet e Lezhës, në të gjitha shkollat e qytetit, dëmtoi dyqanet në tregun e madh dhe askush nuk denjoi të shkojë t'i takojë, ndërsa për dëmshpërblim as që bëhet fjalë. Lumi Drin doli nga shtrati, mori arratinë, sepse investimet për zgjerimin dhe thellimin e tij as janë menduar, aq më pak të parashikohen. Por ndoshta kalimtarët e rastit nuk e dinë që Lezha ka një lumë që quhet Drin dhe që ka nevojë urgjente për investime. Shpresoj ta ketë kuptuar i emëruari i Ramës në Bashkinë Lezhë që lyerja e fasadave nuk e ndalon përmbytjen. Duhet ta duash Lezhën, qytetin, fshatin, të kesh sadopak dhembshuri për të dhe të punosh me përkushtim në atë qytet të vlerave, me vende dhe me njerëz të mrekullueshëm. Po kujt t'ia thuash këtë, hajdutit patologjik këtu brenda apo "vëllezërve siamezë" të masakrës zgjedhore të Dibrës, njëri ministër i Drejtësisë pa drejtësi dhe tjetri kryetar 6% i Bashkisë së Lezhës? Ju nuk keni politika konkrete, por shpikje të momentit për të përfituar politikisht, por që nuk do t'ia dilni dot më. Edhe socialistët e ndershëm në Lezhë e kudo tjetër e kanë kuptuar se kush jeni ju. Të nderuar kolegë, gjendja që po kalon Lezha e mbarë Shqipëria nuk është ajo që ju jua servirni nga ekranet e medieve apo nga dritat verbuese për festa. Është krejt tjetër realiteti që po kalojnë qytetarët e Lezhës atje poshtë. Në një komunikim shkresor që pata me Bashkinë e Lezhës në lidhje me procesin e rindërtimit, më komunikojnë se 40 shtëpi janë në proces për t'u rindërtuar. Ndërkohë, në një dalje publike përfaqësuesi i Bashkisë së Lezhës na bën me dije se, për shkak të rritjes së kostove të ndërtimit, kompania fituese e tenderit tërhiqet, se duhet të rritet fondi nga ana e qeverisë dhe të dilet me një vendim të dytë, në bazë të projektit dhe preventivit që do të bëhet.

Ndaj unë gjej rastin t'i drejtohem publikisht Bashkisë së Lezhës, por edhe ministrisë së urbanistikës, që t'i japë zgjidhje të menjëhershme kësaj çështjeje dhe 40 shtëpitë të rindërtohen sa më shpejt, pasi ato familje kaluan vitin e katërt dhe dimrin e katërt tashmë pa shtëpi mbi kokë. I kam kërkuar Bashkisë së Lezhës një informacion të detajuar në lidhje me çështjen e tërmetit, por ende nuk kam marrë përgjigje. Por pa asnjë dyshim do t'u drejtohem organeve kompetente për të kontrolluar dhe verifikuar procesin e rindërtimit: ku kanë shkuar fondet e rindërtimit nga Bashkia e Lezhës? Kush ka abuzuar me to, Bashkia e Lezhës, ish-Ministria e Rindërtimit apo ministria e urbanistikës? Të dashur banorë të Lezhës, I kuptoj personazhet e dosjes "184", që janë në hall të madh, por, më vjen keq, nuk i ndihmoj dot, janë pakicë e pavotuar dhe ky është fakt. Madje, i njeh mjaft mirë Lezha dhe mbarë Shqipëria. Nuk i shpëton dot gjuha përçart që tentojnë të fusin mes banorëve të Lezhës dhe të të gjitha krahinave që kontribuojnë dhe jetojnë në Lezhë. Besëlidhjen e Lezhës nuk ua kujtojnë dot lezhianëve ata që tjetërsojnë vullnetin e sovranit apo edhe historinë e qytetit! Lezha do t'i japë ndëshkimin e merituar, madje edhe më të madh më 14 maj, kësaj pakice politike, që nuk e lidh asgjë me Lezhën, aq më pak me të ardhmen e saj. E provuat humbjen e thellë më 25 prill 2021, por edhe më e thellë do të jetë humbja më 14 maj! Mos u shqetësoni, do të na keni përballë kudo dhe kurdo! Të dashur banorë të Lezhës, të Kurbinit dhe të Mirditës, Ju ftoj nesër në datën 3 mars, ora 12:00, të mblihdemi përpara Kryeministrisë në një tjetër besëlidhje historike, të bëhemi bashkë kundër së keqes. Sot Shqipëria është në rrezik. Është detyra dhe përgjegjësia jonë të marrim në dorë fatet e vendit, të familjes sonë, të fëmijëve tanë. Bëjeni sot, pasi nesër mund të jetë vonë! Faleminderit!